



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:140819  
Datë: 20.03.2024  
Numri i dokumentit: 05479856

**C.A.P.nr. 1561/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, nga gjyqtari individual Besnik Feka, , në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “A” SH.P.K, me adresë xxxxxx, me nr. unik identifikues: xxxxxx, kundër debitorit I.R., me adresë në: xxxxxx, P., të cilin e përfaqëson Avokat M.B., rr xxxxxxxx, lidhur me çështjen përmbarimore për pagimin e borxhit, duke vendosur në lidhje me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.360/23 i datës 24.07.2023, me datë 20.03.2024 mori këtë:

### A K T V E N D I M

**I.APROVOHET si e bazuar** ankesa e kreditorit “A” SH.P.K, me adresë në xxxxxx, P, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.360/23, i datës 24.07.2023, **NDRYSHOHET**, ashtu që refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit I.R. nga P. ,ndërsa Urdhri për Lejimin e Përmbarimit i Përmbaruesit Privat P.nr.721/23, i datës 30.05.2023, **VËRTETOHET**.

**II.**Secila palë i bartë shpenzimet e saj të procedurës së përmbarimit.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.360/23, i datës 24.07.2023, ka vendosur si në vijim:

**I.APROVOHET** si i bazuar prapësimi i debitorit I. R., **SHFUQIZOHET** urdhri përmbarimor me numër P.nr.721/23 i datës 30.05.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat I. G., dhe **PËRFUNDOHET** në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

**II.**Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit jo të plotë apo të gabuar të

gjendjes faktike, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e kreditorit, të shfuqizohet aktvendimi i ankimuar, apo i njëjti të ndryshohet dhe mbetet në fuqi urdhëri për lejimin e përmbarimit.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur debitori.

Gjyqtari Individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të Nenit 3) paragrafi 2), në lidhje me nenin 77 par.4) të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, në lidhje me nenin 201 pika b) dhe d), nenin 208 dhe neni 209 pika c) të LPK-së gjeti se:

**-Ankesa e kreditorit A. SH.P.K, është e themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 30.05.2023, ka paraqitur propozim pranë organit përmbarues, Përmbaruesit Privat për caktimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës F-23-03-0031595, të datës 23.03.2023, për pagesën e shumës prej 120 euro, në emër të shitjes së shërbimeve të kabllorikut dhe internetit, kundër debitorit I. R. nga Prishtina.

Organi përmbarues me Urdhrin për Lejimin e Përmbarimit, P.nr.721/23 i datës 30.05.2023 e ka lejuar përmbarimin.

Debitori pas pranimit të urdhrin për përmbarim ka ushtruar propozim pranë Gjykatës së shkallës së parë me propozim që të aprovohet propozimi ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet, dhe propozimi për përmbarim të hedhet poshtë si i pa bazë, me arsyetimin se debitori asnjëherë nuk ka nënshkruar dhe pranuar faturë për pagesën e shërbimit të pranuar nga kreditori.

Kreditori brenda afatit ligjor ka ushtruar përgjigje në propozimin e debitorit, duke e kundërshtuar në tërësi të njëjtin me arsyetimin se debitori ka pranuar shërbimin e internetit dhe kabllorikut sipas kontratës me kreditorin dhe se kreditori i ka dërguar njoftimin së bashku me faturën e bashkangjitur për pagesën e borxhit, mirëpo, nga fletëshja vërtetohet se i njëjti i ka refuzuar pranimin e njoftimit dhe faturës për pagesë, andaj, ka propozuar që propozimi të refuzohet.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, e ankimuar e ka aprovuar propozimin e debitorit, ka shfuqizuar urdhërin për lejimin e përmbarimit, duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të saj gjykata e shkallës së parë ka theksuar se gjykata vlerëson se fatura me nr. F23-03-0031595, e datës 23.03.2023, nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarimor, në kuptim të nenit 29 dhe nenit 37 të Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbarimore (në vijim si: LPP).

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbarjes së detyrimit monetar”, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Sipas dispozitave në fjalë Gjykata vlerëson se, dokumenti i besueshëm në bazë të të cilit është lejuar përbarimi, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, kjo për faktin se nga shikimi i dokumentit të besueshëm – faturës me nr. F23-03-0031595, Gjykata vëren se e njëjta nuk është e nënshkruar nga debitori, e për më tepër kreditori nuk ka paraqitur prova tjera përmes të cilave do të mund të argumentonte se borxhi i cili kërkohet të përbarohet, në ndonjë mënyrë tjetër është pranuar nga debitori. Gjendur në këtë situatë, Gjykata vlerëson se vetëm lëshimi i një anshëm i një fature nga kreditori, nuk mund të shërbejë si bazë – titull për realizimin e përbarimit, përderisa borxhi në fjalë nuk është pranuar në ndonjë formë nga ana e debitorit. Faturat janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori, të njëjtat nuk e përmbajnë nënshkrimin e pranuesit - debitorit.

Sa i përket pretendimit të kreditorit në përgjigjen në prapësim lidhur me numrin e urdhrin përbarimor, sipas vlerësimit të Gjykatës, bëhet fjalë për gabim teknik, kjo pasi që data e urdhrin është e shënuar saktë, identifikimi i palëve është i saktë, si dhe nga vet përmbajtja e prapësimit kuptohet se kundërshtohet pikërisht urdhri përbarimor me P.nr. 721/23. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, ky pretendim i debitorit nuk mund të jetë shkak për refuzimin e prapësimit.

Sipas nenit 43 par. 4 të LPP-së: *Përbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngreh kundërshtimin ndaj urdhrin të përbarueshmërisë së nxjerrë nga përbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përbarim nga përbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim. Andaj, gjykata në rastin konkret vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin për përbarim nga përbaruesi privat, sepse është lejuar përbarimi në bazë të një dokumenti i cili është nxjerr nga kreditori në mënyrë të njëanshme.*

Gjykata vendosi për përfundimin e procedurës përbarimore, duke u bazuar në nenin 12, par. 2 të Ligjit nr. 05/1-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/1-139 për procedurën përbarimore, i cili përcakton: “ *Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera*”.

Gjykata, mbi bazën e asaj që është thënë më lart dhe, në bazë të nenit 73 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata e Apelit të Kosovës nuk mund t’ a pranoj qëndrimin dhe mënyrën e vendosjes së gjykatës së shkallës së parë, pasi që vlerëson se gjykata e shkallës së parë konform nenit 183 par.1, në lidhje me nenin 194,195 par.1 pika e) në lidhje me nenin 201 pika b) dhe d) në lidhje me nenin 208 dhe 209, pika c) të LPK-së ,gabimisht ka vlerësuar shkresat e lëndës të cilat kanë rezultuar me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe me zbatim të gabuar të drejtës materiale.

Gjykata e Apelit, ndryshe nga gjykata e shkallës së parë me aprovimin e ankesës së kreditorit dhe nga shikimi i shkresave të lëndës, konstaton se kreditori dhe debitori kanë nënshkruar kontratën e abonimit nr. 57793, të datës 29.06.2021, për shërbimin e internetit dhe kabllovikut, dhe se debitori pas dështimit të përmbushjes së pagesave sipas kontratës, kreditori ka lëshuar faturën me numër F-23-03-0031595, të datës 23.03.2023, për pagesën e shumës prej 120 euro, dhe se këtë faturë së bashku me njoftimin për pagesë përmes postës ka tentuar t'ia dorëzoj debitorit I.R., mirëpo, siç shihet nga flekthesa e postës konstatohet se debitori e ka refuzuar pranimin e këtyre shkresave, ashtu që, i njëjti konsiderohet se ka qenë në dijeni për faturën e kreditorit për pagesë të shumës prej 120 euro, dhe mbi këtë bazë i njëjti ka qenë i njoftuar për faturën edhe pse e njëjta nuk është e nënshkruar, andaj, mbi bazën e nenit 29 par.1, nënpar.1.3 në lidhje me par.2 gjykata e shkallës së dytë konsideron se fatura i plotëson kushtet për lejim të përmbarimit, andaj, edhe vendosi si në dispozitiv të tij, sepse debitori mbi bazën e nenit 8 dhe 245 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-177, detyrohet ti paguajë shumën e borxhit kreditorit.

Prandaj Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të ankesës së autorizuarit të kreditorit, rivlerësimit të provave në shkresat e lëndës vlerëson se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke aprovuar ankesën e kreditorit, duke e ndryshuar aktvendimin e ankimuar duke e refuzuar prapësimin e debitorit ashtu që edhe ka vërtetuar Urdhërin për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat.

Prandaj Gjykata e Apelit në vështrim të nenit 183 par.1, nenit 194, nenit 201 pika b) dhe d), në lidhje me nenin 208 dhe 209 pika c) të LPK-së në lidhje me nenin 17 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**C.A.P.nr.1561/2023, me datë 20.03.2024**

**Gjyqtari Individual**  
**Besnik Feka**